



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

UDHËZIM

Nr. 289 Datë 30. 12. 2002

PËR

**MËNYRËN E MBAJTJES, RUAJTJES DHE PLOTËSIMIT TË EVIDENCAVE
STATISTIKORE NË PROKURORI**

Mesynim,

- për të shmangur pasaktësitë e evidentuaxa në raportimin e të dhënave statistikore, si dhe;
- për plotësimin unik dhe të saktë të të dhënave në evidencat dhe pasqyrat statistikore në prokuroritë e të gjitha niveleve.

Mbështetur, ne nenin 8 pika 2 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02-2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën Shqipërisë" dhe ligjin Nr. 7687 datë 16. 03. 1993 "Për statistikën", si dhe në pikën 2.7 të Urdhërit Nr. 284 datë 19. 12. 2002 Tër mbajtjeri, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në prokurori",

U D H Ë Z O J:

I. EMËRTIMI I FORMULARËVE SIPAS NIVELEVE TË PROKURORIVE

1. Emërtimet e formularëve "**Model Pr 1R**" e vijues përfaqësojnë: gërnia. "Pr", Prokuroritë dhe "**PrU**" Prokuroritë Ushtarake, pranë Gjykatave: të rrethit gjyqësor; shifra "1" nivelin/shkallën e parë të prokurorisë, ndërsa gërma pas shifres nje, si "R", inicialin e emërtimit të evidencave sipas llojeve. I njëjti kuptim është edhe për formulaiët "**Model p lhp**" e vijues që i përkasin prokurorëve të Prokurorive le: këtij niveli;
2. Emërtimet e formularëve "**Model Th 2Pr^M**", "**Model Ms 2Pr**" e vijua përfaqësojnë: gërma "Th", çështjet e themelit, ndërsa "Ms" masate sigurirnit, shifra "**2Pr**", nivelin/shkallën e dytë e Prokurorisë dhe

"2PrU" niveli/shkalla e dytë e Prokurorisë Ushtarake praië Gjykatave të Apeleve përkatëse;

3. Emërtimet e formularëve "**Model Th 3Pr**", "**Model Ms 3Pr**" e vijues përfaqësojnë: gërma "Th^M", çështjet e themelit, ndërsa "Ms" masat e sigurimit, shifra "**3Pr**", nivelin/shkallën e tretë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Lartë;

II. MËNYRA E MBAJTJES, RUAJTJES DHE PLOTËSIMIT TË EVIDENCAVE STATISTIKORE NË TË GJITHË NIVELET E PROKURORIVE

1. Në Prokuroritë e të gjitha niveleve, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, të ndihmuar nga operatori/operatorja ose sekretari/sekretarja përkatëse, evidentojnë dhe administrojnë, treguesit kryesorë të punës, sipas specifikave të tyre, Në çdo kohë sejcili duhet të ketë të evidentuar dhe të dijë treguesit kryesorë të puhës së tij.
2. Në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë, prokurori përkatës, i ndihmuar nga operatori/operatorja ose sekretari/sekretarja, duhet të mbajnë në mënyrë të hollësishme (analitike) dhe kronologjike të dhënat për veprat penale, autorët e kryerjes së tyre dhe gjithë treguesit e tjerë.
3. Të dhenat e pasqyrave të procedimeve penale, **Model p lhpj Model p lp, Model p lpz, Model p ldgj, Model p lgj dhe Model Th IVgj**, si dhe evidencat **Model Th 2 Vgj dhe Model Th 3 Vgj, e vijuese**, të përcaktuara në urdhërin Nr. 284 datë 19. 12. 2002 dhe në" këtë udhëzim, do të mbahen nga prokurorët sipas niveleve të ndihmuar nga operatori/operatorja ose sekretari/sekretarja përkatëse, nën mbikqyrjen e drejtuesve të tyre.
 - a. Këto evidenca të përdoren për të ndihmuar prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorisë, sipas niveleve, për të analizuar në çdo kohe treguesit kryesorë të punës, sipas specifikave të tyre, Në çdo kohë sejcili duhet të ketë të evidentuar dhe të dijë treguesit kryesorë të puhës së tij.
4. Formularët Model Tip, të marre në këtë zyrë, të printuar dhe me
 - për të evidentuar saktë dhe me shifra të kuadrueshme evidencat e tjera periodike 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, si dhe;
 - për të unifikuar, politikën e procedimit penal dhe të kërkesave për ilojë e masa dënimi, rritur cilësinë në ndjekjen penale dhe shpejtësinë në hetimet paraprake, nga sejcili prokuror, në çdo Prokurori të rrethit gjyqësor, në nivel Prokurorie Apelit dhe në shkallë vendi.

CD/Picodisk, në zbatim të udhëzimeve të marra nga Zyra e Teknologjisë së Informacionit, pasi të hidhen në kompjuter dhe/ose në server, të ruhen në arkiv bashkëlidhur urdhërit përkatës dhe këtej udhëzimi, për te rinstaluar formularët në kompjuter dhe/ose rrjetë, • në rastet e difekteve të mundëshme.

a. Në formularët Model Tip, sipas niveleve të prokurorive, **shumat janë të hedhura me formula të gatëshme, të përgatitura nga zyra e statistikës dhe duhet berë shumë kujdes që të mos punohet mbi to dhe të mos fsbihen ose prishen.**

5. Formularët e modeleve të përcaktuara në urdhërin e lartpërmendur dhe në këtë udhëzim, pasi të plotësohen sipas periudhave, mujore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore, të kopjohen në CD, Picodisk ose Disket dhe një kopje të sillet, në afatin e përcaktuar, në zyrën e statistikës të Drejtorisë së Studimeve, ndërsa kopja tjetër të ruhet në arkivin e prokurorive sipas niveleve.

a. Me plotësimin dhe dërgimin në zyrën e statistikës të të dhënave statistikore vjetore, në arkivin e prokurorive sipas niveleve të ruhen në CD ose Disket, vetëm të dhënat statistikore, 6~mujore dhe vjetore, sipas modeleve, duke krijuar kështu në arkivin e prokurorive të të gjitha niveleve bazen e të dhënave periodike statistikore.

6. Të gjithë formularët e evidencave Modël Tip, mbasi të plotësohen nga prokurori që mban regjistrin dhe statistikën, si dhe nga personat e tjerë të përcaktuar në urdhërin e lartpërmendur dhe në këtë udhëzim, duhet të verifikohen dhe të kontrollohen nga drejtuesi i prokurorisë sipas niveleve, për saktësinë e të dhënave/treguesve që pasqyrohen në të. Vetëm pas verifikimit të saktësisë së të dhënave/treguesve të hedhur në formularët sipas modeleve, drejtuesi i Prokurorisë nënshkruan shkresën përcjellëse për dërgimin e statistikës me CD/Picodisk ose Disket në zyrën e statistikës.

II-I. MËNYRA E FLOTËSIMIT TË EVIDENCAVE NË PROKURORITË PRANË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE

1. Në **Prokuroritë pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore**, në plotësimin e evidencave dhe pasqyrave statistikore, të respektohen rregullat si më poshtë:

A. Evidenca e referimit të veprave penale, Model Pr 1R, të plotësohet për të pasqyruar në të, drejtë dhe saktë, të dhënat e përcaktuar sipas kolonave, për kallëzimet dhe referimet e veprave penale në prokurori, si dhe sipas reshtave ku janë grupuar vepra penale të permblëdhura në kreret e Kodit Penal. Shuma e kallëzimeve dhe referimeve, kolona 13, duhet të jetë produkt i shumës së kolonave 2 deri 12.

B. Evidenca e masave të sigurimit personal, Model Pr 1Ms, të

plotësohet për të pasqyruar, drejtë dhe saktë, të dhënat e përcaktuara sipas kolonave dhe grupimeve në to, ku pasqyrohen "masat provizore të sigurimit", "kërkesat e prokurorit...*", "vendimet e gjykatës", "apelime të prokurorit" dhe "zgjidhjet në* Gjykatën e Apelit", si dhe sipas rreshtat ku janë grupuar krerët dhe seksionet e Kodit Penal, si dhe disa krime të rënda. Shuma totale e treguesve të çdo kolone nuk duhet të mbledhet me të gjithë rreshtat, por vetëm me rreshtat e krerët përkatës ku përfshihet edhe shuma sipas veprave penale të specifikuara në evidencë.

C. **Evidenca e treguesve të ndjekjes penale, sipas veprave penale, Model Pr. IVp**, përbën formularin kryesor dhe me të dhëna të detajuar të ndjekjes penale në fazën e hetimeve paraprake dhe në fazën e ngritjes dhe përfaqesimit të akuzës në gjykatë, Kjo evidence duhet të plotësohet me rigorozitet të madh, për të pasqyruar drejtë të dhënat që kërkohen.

- a. Procedimet/çështjet dhe treguesit vijues do të evidentohen sipas veprave penale, për të cilat është bërë regjistrimi i tyre.
- Kur çështja është regjistruar për dy ose më shumë vepra penale, atëherë çështja do të evidentohet për veprën penale që përmban akuzën më të rëndë.
 - Kur çështja ka disa të pandehur që akuzohen për vepra penale të ndryshme, evidentimi i saj do të bëhet për veprën penale më të rëndë, duke pasqyruar dhe numrin e të pandehurve dhe të arrestuarve për akuzën më të rëndë, ndërsa numri i të pandehurve të tjera do të regjistrohet vetëm për veprën penale që ato akuzohen, pa u shënuar si çështje më vehte.

b. **Kuadrimet që duhet të përmbushë formulari kryesor statistikorë Model Pr 1 Vp**, ndonëse në CD janë me formula të plotësuara, po i sqarohet në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

- **Kuadrimi i kolonave sipas treguesve dhe veprave penale është;**
 - **Kolona Nr. "4", çështjet/procedimet e mbartura** duhet të jetë e barabartë me **çështjet e mbetura në hetim** në periudhën paraardhëse. Gjithashtu, **kolonat Nr. "5 e 6"**, për të **pandehurit dhe arrestuarit**, duhet të jenë të barabarta me të **pandehurit dhe të arrestuarit e mbetur në hetim** në fund të vitit, 3-mujorit, 6-mujorit ose 9-mujorit, paraardhës;
 - Të dhënat e **kolonës "16"**, shuma e procedimeve të ndjekura **"Sl:Gjithësej"**, duhet të jetë e barabartë rjie shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (4+7+10+13)-Të dhënat e **kolonës "17", shuma e të pandehurve**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (5+8+11+14), ndërsa të dhënat e **kolonës "18% shuma e të arrestuarve**, duhet të jetë e barabartë me shurnën e të dhënave përkatësisht të kolonave (6+9+12+15);

- Të dhënat e **kolonës "22", shuma e çështjeve të pushuara**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (19+20+21). Të dhënat e **kolonës "26", shuma e të pandehurve që i është pushuar çështja**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (23+24+25);
- Të dhënat e **kolonës "33", shuma e çështjeve të pezulluara**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (31+32);
- Të dhënat e **kolonës "42", gjithësejt çështje te përfunduara**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave, përkatësisht të kolonave (22+33+36+39). Të dhënat e **kolonës "43^w, shuma e te pandehurve, për çështjet e përfunduara (S2)**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (26+34+37+40), ndërsa të dhënat e **kolonës "44"**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave, përkatësisht të kolonave (27+35+38+41);
- **Kolona "45", për çështjet e mbetura në hetim**, duhet të jetë e barabartë me diferencën e të dhënave përkatësisht të kolonave (16-42). **Kolona "46", për shumën e të pandehurve të mbetur në hetim**, duhet të jetë e barabartë me diferencën e të dhënave, të kolonave (17-43), ndërsa të dhënat e **kolonës "47", të arrestuar të mbetur në hetim**, duhet të jenë të barabarta me diferencën e të dhënave, të kolonave (18-44);
- **Kolona Nr. "48", çështjet e mbartura në gjykim** duhet të jenë të barabarta me **çështjet e mbetura në gjykim** në periudhën paraardhëse. Gjithashtu, **kolonat Nr. "49 e 50", për të pandehurit dhe arrestuarit**, duhet të jenë të barabarta me **te pandehurit dhe te arrestuarit e mbetur në gjykim** në fund të vitit, 3-mujorit, 6-mujorit ose 9-mujorit, paraardhës;
- Të dhënat e **kolonës "51", shuma e procedimeve në gjykitn. "Gjithësejt në gjykim (S3)"**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (39+48). Të dhënat e **kolonës "52", shuma e të pandehurve**, duhet të jetë e barabarte me shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (40+49), ndërsa të dhënat e **kolonës "53", shuma e të arrestuarve**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave përkatësisht të kolonave (41+50);
- Të dhënat e **kolonave "54, 56, 58 e 60"**, duhet të jenë të barabarta me **shumën e çështjeve, përkatësisht dhe tëV pandehurve të gjykuar, përkatësisht kolonat "93 e 94"** pavarësisht nga Uoji i gjykimit, sepse për të njëjtën çështje mund të ndodhë që të keni dy lloje gjykimi, të drejtpërdrejtë dhe të shkurtuar ose gjykim të zakonshëm dhe në mungesë; - Të dhënat e **kolonave "62 deri 74" të emërtuara "Kërkesa të Prokurorit"**, përfaqësojnë disponimet e prokurorit në përfundim të shqyrtimit

gjyqësor, për çdo të pandehur dhe jo për çështje. Te dhënat e këtyre kolonave duhet të jetë e barabartë me **shumën e të pandehurve të gjykuar kolona "94"**. Gjithashtu kjo shifër duhet të jetë e barabartë edhe me shumën e të dhënave të **kolonave "75 deri 87"** të emërtuara **"Vendimi i Gjykatës"**, pavarësisht se vlera e shifrave për kolona me emërtime të njëjta mund të jetë e ndryshme;

- Të dhënat e **kolpnës "96"**, **"Mpeten në Gjykim (S3-S4)** që përfaqëson **shumën e çështjeve që ngelen në gjykim**, duhet të jetë e barabartë me diferencën e të dhënave, të kolonave (51-93). Gjithashtu, **kolonat 97 e 98, per shumën e të pandehurve dhe të arrestuarve**, duhet të jenë të barabarta me diferencat e të dhënave, përkatësisht kolonave (52-94) dhe (53-95);
- Të dhënat për **kolonat, "Gjinia"% "Grupmosha", "Arësimi", "Gjendja shoqërore", "Vend banimi", dhe "Përsëritësa"**, duhet të jenë të barabarta midis tyre në total, pra ato të* pandehur që janë detajuar- sipas gjinisë duhet të jenë të barabartë me ata të detajuar sipas grup moshës, e kështu me radhë, si dhe **totali** i tyre duhet të jetë i barabartë me **totalin** e të pandehurve në kolonën "43", pra për çështjet e perfunduara ne hetim;
- Të dhënat e **kolonës "119"**, **gjithësejt gjendja shoqërore**, duhet të jete e barabartë me shumën e të dhënave, të kolonave (110+117+118). Emërtesat e gjendjes shoqërore në sektonn shtetëror, në zbatim të ligjit Nr. 8095 date 21. 03. 1996 "Për shërbimin civil në R. Sh", neni 2 pika 1 e vijues dhe të ligjit Nr. 8594 datë 11. 11. 1999 "Për statusin e nëpunësit civil, nenet 2, 7 e vijues dhe ligje te tjera, duhen kuptuar e shënuar si më poshtë:
 - Emërtimi, **Funksionar, Kolona "111"**, konsiderohen personat subjekt i nenit 75/b, pika 2eK. Pr. Penale dhe funksionarët e tjerë politik që ushtrojnë funksione drejtuese politike në administratën publike qendrore dhe vendore;
 - Emërtimi, **Nëpunës i nivelit të lartë drejtues, Kolona "112"**, konsiderohen nëpunësit civil ne pozicionet drejtuese si: *sekretar i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor drejtorie të përgjithshme, pozicione të barazvlefshme me to* në Institucionet e Administratës Publike qendrore e vendore, ku përfshihet: Administrata e Kuvendit, Administrata e Presidentit, Aparati i Këshillit të Ministravë, ministrive, institucioneve qendrore të pavarura, bashkive dhe qarqeve;
 - Emërtimi, **Nëpunës i nivelit të mesëm drejtues, Kolona "113"**, konsiderohen nëpunësit civil ne pozicionet **drejtuese si: drejtor drejtorie dhe pozicionet e barazvlefshme me to**;
 - Emërtimi, **Nëpunës i nivelit të ulët drejtues, Kolona "114**"**, konsiderohen nëpunësit civil në pozicionet si: **shef sektori, shef zyre dhe pozicionet e barazvlefshme me**

to;

- Emërtimi, **Nëpunës i nivelit ekzekutues, Kolona "115"**, konsiderohen nëpunësjt civilspecialiste të-instituGioneve-të administratës publike të nivelit qëndror dhe/ose vëhdor;
- Emërtimi, **Nëpunës i thjeshtë, Kolona "116"**, përfshin **punonjësit e tjerë të administrates publike, që si Punonjësit e Sek. Privat**, lidhin kontrata individuale apo kolektive me punëmarrësin dhe marrëdhëniet e tyre rregullohen bazuar në K. Punës.

• **Kuadrimi i rreshtave sipas çdo koke te kolonave është:**

- Rreshti, **kreu.I.** është i barabart me shumën e rreshtave të neneve 73,74,75;
- Rreshti, **kreu.II.** është i barabart me shumën e seksioneve të veta, pra nga seksioni 1 deri tek seksioni 10;
 - Rreshti , **Sek.I,** është i barabartë me shumën e rreshtave të neneve përkatës 76 deri 84;
 - Rreshti, **Sek.II,** është i barabartë me rreshtin e nenit 85;
 - Rreshti, **Sek.III,** është i barabarte me shumën e rreshtave për nenet 86-90;
 - Rreshti, **Sek.FV,** është i barabarte me shumën e rreshtave për nenet 91 e 92;
 - Rreshti, **Sek.V,** është i barabartë me shumën e rreshtave për nenet 93-99;
 - Rreshti, **Sek.VI,** është i barabartë me shumën e rreshtave për nenet 100-108;
 - Rreshti, **Sek.VII,** është i barabartë me shumën e rreshtave për nenet 109-112;
 - Rreshti, **Sek.VIII,** është i barabartë me shumën e rreshtave për nenet 113-123;
 - Rreshti, **Sek.IX,** është i barabartë me shumën e rreshtave për nenet 124-130;
 - Rreshti, **Sek.X,** është i barabartë me shumën e rreshtave për nenet 131-133;
- Rreshti, **Kreu.III,** është i barabartë me shumën e rreshtave të seksioneve 1 deri 11;
- E kështu me radhë shumat e seksioneve janë të barabarta me shumën e rreshtave të neneve përkatëse, për të cilat theksojmë se në CD janë të hedhura formulat e shumave.
- Në fund rreshti **Sh_Tot:** që është **(Shuma Totale),** është e barabartë me shumën e rreshtave të krerëve përkatës, pra nga Kreu I. deri te kreu i **XI.**

D. Evidenca e zgjatjeve të afatit të hetimeve paraprake, Model Pr 1 Zgj, të plotësohet për të pasqyruar, drejtë dhe saktë, të dhënat e përcaktuara sipas kolonave dhe grupimeve në to, ku pasqyrohen "zgjatjet deri në 3-muaj", "mbi

3-muaj deri ne 6 muaj" "mbi 6-muaj deri në 9-muaj", "mbi 9-muaj deri në 1-vit" dhe "mbi 1-vit", si dhe sipas rreshtave ku janë grupuar krerët e veprave penale që parashikon Kodi Penal.

- a. Kjo evidence pasqyron zgjatjet e afatit te hetimeve paraprake per ceshtjet e përfunduara.
- b. Duhet treguar kujdes, që çështja, për të cilën vendoset zgjatje e afatit të hetimeve të shënohet vetëm një herë, pavarësisht se sa zgjatje janë vendosur për të. Kështu:
 - kur vendoset zgjatje afati deri ne 3-muaj evidentohet tek kolona 1,
 - kur vendoset zgjatje afati dy herë, 3-muaj + 2 muaj, evidentohet tek kolona 4, e kështu me radhë, përkatësisht edhe numri i të pandehurve dhe i të arrestuarve.

Shuma e zgjatjeve të hetimeve, "Sgj", përfaqëson në **Kolonën "16"** shumën e çështjeve ose shumën e kolonave (1+4-f-7+10+13j, e kështu me radhë, në **Kolonën **17"** shumën e të pandehurve dhe në **Kolonën "18"** shumën e të arrestuarve, për të cilët është vendosur zgjatje e afatit të hetimeve. Totali i treguesve të çdo kolone duhet të mblihdhet me te gjithë rreshtat, sipas krerëve përkatës të veprave penale.

E. Evidenca e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të forntës **së prerë, Model Pr 1Ek**, të plotësohet për të pasqyruar, drejtë dhe saktë, të dhenat e përcaktuara sipas kolonave dhe grupimeve në to, siç janë: "urdhërat për ekzekutim"* të nxjerra nga prokurori, "vendime të ekzekutuara", "vendime të paekzekutuara" megjithëse është nxjerr urdhëri i ekzekutimit nga prokurori, "vendime të mbartura pa u ekzekutuar" nga periudha paraardhëse, si dhe sipas rreshtave ku janë grupuar krerët e veprave penale që parashikon Kodi Penal.

- a. **"Vendimet e mbartura të paekzekutuara"** përfaqësojnë të gjithë personat e dënuar me vendime gjyqësore të forntës së prerë, sipas llojeve të dënimit në kolonat **"16 deri 19"**, për të cilët prokurori ka urdhëruar ekzekutimin ne periudhat paraardhëse, por vendimi nuk është ekzekutuar akoma, siç mund të jenë rastet, e mosekzekutimit të dënimit me burgim, në muaj apo vite të shkuara, të pa amnistuara, për të gjykuarit në munges apo për të gjykuarit me masë "detyrim për t'u paraqitur në polici gjyqësore", etj.
- b. Duhet treguar kujdes, në mbikqyrjen, evidentimin dhe hedhjen e saktë në formular të këtyre vendimeve gjyqësore të paekzekutuara, si të mbartura ashtu dhe të periudhës raportuese, që përfaqësojnë çdo person të dënuar dhe jo çështje. Kështu:
 - **Kolona "21"**, përfaqëson shumën e te **dënuarve me burgim të përjetshëm të paekzekutuar** dhe përfshin shumën e kolonave

(11+16), përkatësishtë vendimeve të paekzekutuara dhe vendimeve të mbartura të paekzekutuara.

- **Kolona "22"**, përfaqëson shumën e të **dënuarve me burgim të paekzekutuar** dhe përfshin shumën e kolonave (12+17), e kështu me radhë, për dënimet me gjobë, dënimet plotësuese dhe shumën totale të vendheneve të paekzekutuara.

Ndersa totali i treguesve të çdo kolone duhet të mblidhet me të gjithë rreshtat, sipas krerëve të veprave penale përkatës,

F. Evidenca e treguesve të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, Model Pr IMj, të plotësohet për të pasqyruar, drejtë dhe saktë, të dhënat e përcaktuara sipas kolonave dhe grupimeve në to, siç janë: "ekstradimi për jashtë shtetit", "ekstradimi nga jashtë shtetit", "letërporosia nga jashtë", "letërporosia për jashtë", "njohja e vendimeve penale të huaja" dhe "ekzekutimi i vendimeve penale shqiptare", si dhe sipas rreshtave ku janë grupuar krerët e veprave penale që parashikon Kodi Penal. **Totali** i treguesve të çdo kolone dhe shumave përkatëse duhet të mblidhet me të gjithë rreshtat, sipas krerëve të veprave penale.

G. Evidenca me tregues të procedimeve penale të gjykuara, sipas vendimeve gjyqësore, në Prokuroritë pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore Model Th 1 Vgj, siç përcaktohet dhe në urdhrin përkatës, plotësohet në dinamik dhe në të pasqyrohen në mënyrë analitike treguesit e kërkuar.

- a. Kjo evidencë mbrenda datës 5 të çdo muaji, duke filluar nga muaji shkurt 2003, për periudhën e muajit janar dhe në vazhdim duhet të depozitohet me CD dhe e printuar në zyrën e statistikës të Drejtorisë së Studimeve.
- b. Për efekt të administrimit të bazës së të dhënave që grupohen në këtë evidencë, mbështetur në konkluzionet perfundimtare të prokurorëve dhe në vendimet gjyqësore penale të vitit 2002, mbrenda datës 31 mars 2003 të evidentohen në rrjetin kompjuterik të të gjithë rretheve gjyqësore treguesit e procedimeve penale të gjykara në periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2002.
- c. Evidenca **Model Th IVgj**, duhet të plotësohet me iniciale të koduara në mënyrë të unifikuar në të gjitha nivelet e prokurorive, për të krijuar mundësinë e filtrimeve nga programi "**Exel**" të treguesve të njëjta. Kështu, duhet të bëhet kujdes në kodimet e emërtimeve të kolonave si më poshtë:
 - "**Nr.Proc**", përfaqëson numrin rendor të procedimeve të gjykuara, 1,1,3...e me radhë;
 - "**Nr.Pand**", përfaqëson numrin rendor të pandehurve të gjykuar,

l[^]S.-e me radhë, por që mund të mos korespondojë dhe/ose të jetë më i madh se numri rëndor i procedimeve;

- **"Emri Mbiemri i Prokurorit****, përfaqëson inicialin e emrit dhe mbiemrin e plotë të prokurorit të çështjes, p.sh. **I. Vata**;
- **"Procedimi, Nr. Datë"**, përfaqëson numrin e regjistrimit të procedimit dhe datën e regjistrimit, p.sh. Nr. **121** Datë **26.09.02**;
- **"Akuza, kryesore/plotësuese**, përfaqësojnë nenin e akuzës së ngritur në gjykatë. Kur ka dy ose më shumë akuza, kryesore është ajo për veprën penale më të rëndë dhe të tjerat janë plotësuese, p.sh. Akuzë kryesore 78, dhe plotësuese **278/2**;
- **"Pasoja e V.Penale"**, përfaqëson pasojën e ardhur, p.sh. në një vrasje rreth pasojë vdekje duhet shënuar **lvdek**, ose në një tentativë vrasje me pasojë plagosje të rëndë duhet shënuar **lpk** ose për plagosjen e lehtë **lpL**, ndërsa në rastet e yjedhje, dëmtimi ose shpërdorimi duhet shënuar vlefshëm si: **10mijL** ose **10mij\$** që nënkupton 10 mijë lekë ose 10 mijë dollar amerikan, apo sasia e drogës në kg ose gr, si: **10kgCS** që nënkupton 10 kg kanabis sativa etj;
- **"Të pandehurit"**, përfaqëson inicialin e emrit dhe mbiemrin e të pandehurit, p.sh, **V.Lika**;
- **"Masa e Sigurimit"**, përfaqëson masën e sigurimit personal, ndaj të pandehurit të dërguar në gjyq, sipas nenit të K.Pr. Penale, p.sh. **238** për Arrestin në Burg, **237** për Arrestin në Shtëpi, **236** për Garancinë Pasurore, apo **234** për Detyrimin e Paraqitjes në Polici Gjyqësore, etj;
- **"Kohëzgjatja në Hetim"** përfaqëson afatin kohor në ditë apo muaj të përfundimit të hetimeve paraprake, p.sh. **Direkt** për Dërgimin me Gjykim të Drejtperdrejtë, ose **15d** për dërgimin në gjyq brenda 15 ditëve, apo 4m për dërgimin në gjyq brenda 4 muajve, **lv** për dërgimin në gjyq brenda 1 viti, e kështu me radhë;
- **"Kohëzgjatja në Gjykim"**, përfaqëson afatin kohor që ka përfunduar gjykimi, duke shënuar inicialet si më sipër;
- **"Kërkesa e Prokurorit"**, me emërtimet e përcaktuara, sic janë:
 - **"Ll.Gjykimit"**, përfaqëson llojin e gjykimit të kërkuar dhe/ose pranuar edhe nga prokurori, sipas neneve si p.sh. **400** për gjykimin e drejtperdrejtë, **403** për gjykimin e shkurtuar, **Zakon** për gjykimin e zakonshëm;
 - **"Gjendja"**, përfaqëson gjendjen në fakt ose në mungesë të të pandehurit të gjykuar, p.sh. **Mung** për gjykimin në mungesë ose **Fakt** për gjykimin në prani të të pandehurit;
 - **"Zgjidhja"**, përfaqëson kërkesat e prokurorit për zgjidhjen ligjore të kërkuar, p.sh. **Faj** për fajësi, **Pafaj** për pafajësi,

PÇesh për pushim çështje, **PAk** për pushim akuze, Nd/Ak+nenin e akuzës së ndryshuar, apo **T.akt** për tërheqjen e akteve;

- "**Ll.Dënimit**", përfaqëson llojin e dënimit të kërkuar nga prokurori, p.sh. **Burg** për burgimin ose **BPerj** për burgimin e përjetshëm, **Gjob**, për gjobën e kërkuar, etj;
 - "**Masa**", përfaqëson masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, sipas llojit të dënimit, p.sh. **6m** ose **1 vit**.
 - përkatësishtë për 6 muaj ose 1 vitë burgim ose **100mij** për dënimin me 100 mijë lekë gjobë;
 - "**D.Plotësues**", përfaqëson llojin e dënimit plotësues të kërkuar nga prokurori, p.sh. **H.Pat** për heqjen e patentës etj
- "**Vendimi i Gjykatës**", me emërtimet e përcaktuara, duhet të plotësohet ashtu siç u udhëzua për disponimet e prokurorit, duke shtuar shënimin e numrit dhe datës së vendimit të gjykatës p.sh. Nr. **21** datë **26.12.02**;
 - "**Apeluar**", përfaqëson subjektin që ka bërë apelimin, p.sh. **Prok** për prokurorin ose **Pand** për të pandehurin;
 - "**Përfundimi***", përfaqëson zgjidhjen e dhënë nga Gjykata e Apelit, p.sh. **LFuqi** për lënien në fuqi, **Hdore**, për heqjen dorë nga apeimi, **NdVend** për ndryshimin e vendimit, **KthRigj** për kthimin për rigjykim, etj;
 - "**Rekurs**", përfaqëson rekursin kundër vendimit të Gjykatës së Apelit të bërë nga subjektet si p.sh. **Prok** për rekursin e Prokurorit të Apelit ose **Pand** për rekursin e bëra nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij;
 - "**Përfundimi**", përfaqëson zgjidhjen e dhënë nga Gjykata e Lartë, p.sh. **LFuqi** për lënien në fuqi, **Hdore**, për heqjen dorë nga apelimi, **KthRigj** për kthimin për rigjykim, etj;

H. Pasqyrat e procedimeve penale: në hetimet paraprake Model p Ihp, të pushuara Model p lp, të pezulluara Model p lpz, të dërguara në gjykatë Model p ldgj dhe të gjykuara Model p lgj, do të plotësohen në kompjuter nga çdo prokuror në Prokuroritë pranë Gjykatave të rrethit gjyqësor, i ndihrrmar nga operatori/sekretari, duke pasqyruar në to, në dinamikë, ndryshimet sipas zgjidhjeve përfundimtare ligjore të procedimeve.

2. Në plotësimin e evidencave dhe pasqyrave statistikore të **Prokurorive pranë Gjykatave Ushtarake të rretheve gjyqësore**, të respektoben të gjithë rregullat e që u përmendën në këtë udhëzim për plotësimin e evidencave dhe pasqyrave sipas modeleve të Prokurorive pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore, duke treguar vëmendjen e duhur, në **veçoritë e përgjithshme të tyre, që lidhet me veprat penale ushtarake dhe grupimin e tyre sipas krerëve të pjesës së posaçme të Kodit Penal Ushtarak**, si dhe në disa veçori specifike që po shtjellojmë, për disa modele evidencash, si më poshtë:

A. Në **Evidencën e referimit të veprave penale, Model PrU 1R**, shuma e kallëzimeve dhe referimeve, kolona 9, duhet të jetë produkt i shumës së kolonave 2 deri 8.

B. Në **Evidencën e treguesve të ndjekjes penale sipas veprave penale ushtarake, Model PrU 1R**, të dhënat e **kolonës "119"**, gjithësejt gjendja **shoqërore**, duhet të jetë e barabartë me shumën e të dhënave, te kolonave (110+114+118).

- Emërtimet **oficer, nënoficer dhe ushtar**, përkatësishtë **kolonat "111, 112 e 113"** janë në zbatim të nenit 5 e vijues të ligjin Nr. 8670 datë 26. 10. 2000 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të R. Sh."
- Emërtimet, **Role të lartë, të mesme, bazë**, përkatësishtë **kolonat "115, 116 e 117"**, janë në zbatim të 'nenit 15/2 të ligjit Nr. 8553 datë 25. 11. 1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe nenit 5 e vijues të ligjit Nr. 8643 datë 20. 07. 2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit."
- **Kuadrimi i rreshtave sipas çdo koke të kolonave është:**
 - Rreshti, **kreu.I.** është i barabart me shumën e rreshtave të neneve 15,16,17,18,19,20,21,22,23,24;
 - Rreshti, **kreu.II.** është i barabart me shumën e rreshtave të neneve 25,26,27,28,29,30,31,32;
 - E kështu me radhë shumat e rreshtave të neneve përkatëse, për të cilat në formularët në CD janë të hedhura formulat e shumave sipas krerëve.
 - Në fund rreshti **Sh_Tot:** që është **(Shuma Totale)**, është e barabartë me shumën e rreshtave të krerëve përkatës, pra nga Kreu .1. deri të kreu i **VII.**

II-II. MËNYRA E PLOTËSIMIT TE EVIDENCAVE NE PROKURORITE PRANE GJYKATAVE TE APELEVE

1. Evidencat statistikore **Model Th 2Pr, Model Ms 2Pr, Model Th 2Vp, Model Ms 2Vp** dhe **Model Th 2Vgj**, që u përkasin **Prokurorëve pranë Gjykatave të Apelit**, si dhe evidencat **Model Th 2PrU, Model Ms 2PrU, Model Th 2VpU, Model Ms 2VpU** dhe **Model Th 2VgjU**, që i përkasin **Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Ushtarak**, të përcaktuara në urdhërin e përmendur dhe në këtë udhëzim, janë të konceptuara me tregues të njëjtë, sipas dy grupimeve, për **gjkimet e themelit "Th*dhe për gjkimet e masave të sigurimit "Ms"**, sipas rretheve gjyqësore, civile ose ushtarake dhe sipas veprave penale, të zakonshme ose ushtarake, por që ndryshojnë ndërmjet tyre vetëm në emërtimet e Prokurorive të rretheve gjyqësore që përfshihen në kompetencën territoriale të tyre, si dhe në emërtimet veprave penale që janë në kompetencën lëndore të tyre. Në plotësimin* e tyre krahas rregullave të lartpërmendura në* këtë udhëzim të respektohen disa rregulla të specifikuar si më poshtë:

A. Evidencat e treguesve për çështjet e shqyrtuara në themei dhe për shqyrtimin e masave të sigurimit personal, sipas prokurorive të rrethit gjyqësor, civile dhe/ose ushtarake, Model Th 2Pr e Model Ms 2Pr dhe Model Th 2PrU e Model Ms 2PrU, të plotësohen për te pasqyruar, drejtë dhe saktë, të dhënat e përcaktuara sipas kolonave dhe grupimeve në to, siç janë: "çështjet e apeluara", ku përfshihen apelime të prokurorit dhe shkaqet e tyre, apelet kundërshtuese të prokurorit, etj, "qëndrimi i prokurorit të apelit", si dhe kërkesat e grupura të prokurorit të apelit, që i përgjigjen zgjidhjet e përcaktuara në kolonat e grupuara "vendimi gjykatës", për çështjet e themelit, sipas nenin 428 e vijues të K. Pr. Penale dhe për masat e sigurimit personal, sipas nenit 249/6 e vijues të K. Pr, Penale, si dhe sipas rreshtave ku janë grupuar "emërtimet e Prokurorive të rretheve gjyqësorë", civilë apo ushtarake që përfshihen ne Prokurorinë e Apelit. **Totali** i treguesve të çdo kolone dhe shumave përkatëse duhet të mblidhet me të gjithë rreshtat, sipas Prokurorive pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore, civile ose ushtarake.

B Evidencat e treguesve për çështjet e shqyrtuara në themel dhe për shqyrtimin e masave të sigurimit personal, sipas veprave penale, Model Th 2Vp e Model Ms 2Vp dhe Model Th 2VpU e Model Ms 2VpU, që janë me tregues të njësuar të kolonave me ato të përmendura me siper në **gërmën "A"**, të plotësohen për të pasqyruar, drejtë dhe saktë, të dhënat e përcaktuara sipas rreshtave, ku duhet të tregohet kujdes në vendosjen neneve sipas akuzave për veprat penale në ngarkim të te gjykuarve. Kështu:

- a. kur çështja është në ngarkim të dy ose më shumë të pandehurve që akuzohen për më shumë se dy vepër penale të njëjta, atëherë çështja dhe të pandehurit do të evidentohet për veprën penale që përmban akuzën më të rëndë.
- b. kur çështja është në ngarkim të disa të pandehurve që akuzohen për vepra penale të ndryshme, evidentimi i çështjes do të bëhet për veprën penale më të rëndë, duke përfshirë në këtë resht edhe numrin e të pandehurve dhe të arrestuarve për këtë vepër, ndërsa numri i te pandehurve të tjera do të regjistrohet sipas veprës penale që ato akuzohen, pa u shënuar si çështje më vehte.

Totali i treguesve të çdo kolone dhe shumave përkatëse duhet të mblidhet me të gjithë rreshtat, sipas krerëve të veprave penale të gjykuara në periudhën raportuese.

C. Evidenca me tregues të procedimeve penale të gjykuara, sipas vendimeve gjyqësore, në Prokuroritë pranë Gjykatave të rrethere gjyqësore, civile dhe ushtarake Model Th 2Vgj dhe Model 1r*

2VgjU, do të plotësohet në dinamik, duke pasqyruar në të, në menyrë analitike treguesit e kërkuar.

- a. Kjo evidencë, ashtu si ato Model Th IVgj e Model Th 1 VgjU, teS rretheve gjyqësore të shkallës së parë, mbrenda datës 5 të çdo muaji, duke filluar nga muaji shkurt 2003, për periudhën e muajit janar dhe në vazhdim duhet të depozitohet me Picodisk ose Disket dhe e printuar në zyrën e statistikës të Drejtorisë së Studimeve.
- b. Këto evidenca duhet të plotësohet me iniciale të koduara në menyrë të unifikuar, siç përcaktohet në "**Seksionin II-I. pika 1, gërma G**" të këtij udhëzimi, për të krijuar mundësinë e mtrimeve nga programi "**Exel**" të treguesve të njëjtë në këtë evidencë analitike.

II-III. MËNYRA E PLOTËSIMIT TË EVIDENCAVE NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË LARTË

1. Evidencat statistikore **Model Th 3Pr, Model Ms 3Pr, Model Th 3Vp, Model Msi "3Vp** dhe **Model Th 3Vgj**, që i përkasin **Drejtorisë Gjyqësore të kësaj zyre për çështjet e përfaqësuar në Gjykatën e Lartë**, ashtu si formularët e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit, janë të konceptuara me tregues të njëjtë, sipas dy grupimeve, për **gjykimet e themelit "Th" dhe për gjykimet e masave të sigurimit "Ms"**, sipas rretheve gjyqësore, civile ose ushtarake të shkallës së parë dhe apeleve, si dhe sipas veprave penale, të zakonshme ose ushtarake. Këto evidenca ndryshojnë ndërmjet tyre vetëm në emërtimet e Prokurorive të rretheve gjyqësore që përfshihen në kompetencën territoriale të Apeleve, civile dhe ushtarake, si dhe në emërtimet e veprave penale, të zakonshme dhe ushtarake, që janë në kompetencën lëndore të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë.
 - a. Në plotësimin e këtyre evidencave do të respektohen rregullat e lartpërmendura në këtë udhëzim, veçanarisht ato të përcaktuara në "**Seksionin II-H. Pika 1, gërmat A, B, C**", duke treguar vemendjen e duhur në veçorit e specifikuar në kolonat e grupuara lidhur me kërkesat e prokurorit dhe vendimet e Gjykatës së Lartë, sipas nenit 441 e vijues të K. Pr. Penale për çështjet e themelit dhe sipas nenit 249 e vijues të K. Pr. Penale për masat e sigurimit personal.

III. ZBATIMI DHE PËRGJEGJESIA PËR SHKELJET

1. Për të ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, operatorët/sekretarët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve, si dhe të strukturave të kësaj zyre.
2. Zyra e Teknologjisë së Informacionit e kësaj zyre të marrë masat e duhura, që **brenda datës 10. 01. 2003, të përfundojë instalimin e paisjes CD_WRITER në kompjuterat e Prokurorive pranë Gjykatave të rretheve**

gjqësore, si dhe në vazhdimësi, të udhëzojë shmangien e paqartësive të mundëshme teknike në prokuroritë e të gjitha niveleve, për mënyrën e kopjimit të të dhënave nga CD/Picodisku në kompjuter dhe anasjelltas.

3. Zyra e Statistikës në Drejtorinë e Studimeve të marrë masat e duhura përgatitore dhe organizative për të grumbulluar, hedhur dhe përpunuar të dhënat statistikore, sipas treguesve dhe niveleve të prokurorive, si dhe të informojë Prokurorin e Përgjithshëm për shkelje të këtij udhëzimi e urdhërit perkatëstë dhe personin përgjegjës.
4. Mospërbushja e detyrave dhe rregullave të percaktuara në këtë udhëzim, për mbajtjen, plotësimin dhe ruajtjen e evidencave dhe pasqyrave statistikore, përbën shkelje të disiplinës në pUnë, neni 32 gërma "b" e ligjit Nr.8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", etj.
5. Për shkelje të disiplinës në zbatimin e këtij udhëzimi fillon procedimi disiplinore, ndaj prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, operatorëve/sekretarëve ose drejtuesve të Prokurorisë të të gjithë niveleve.

IV. HYRJA NË FUQI

1. Për të dhënat statistikore të vitit 2002, prokuroritë e të gjithë niveleve, mbrenda datës 15 janar 2003, të dorëzojnë evidencat përkatëse në CD/Picodisk, në zyrën e statistikës.
2. Udhëzuesit "Për mënyrën e mbajtjes, plotesimit dhe raportimit të treguesve statistikore të ndjekjes penale sipas veprave penale", të dalë në zbatim të urdhërit Nr. 5/1 datë 8. 07. 1998 "Mbi vënien në zbatim të formularëve dhe evidencave të reja Statistike në fushën e veprave penale", si dhe çdo akt tjetër normativ i kësaj zyre që bie në kundërshtim me kërkesat e këtij udhëzimi, shfuqizohen.
3. Me këtë udhëzim të njihen operatorët/sekretarët, oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e të gjithë niveleve të Prokurorisë.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PERGJITHSHEM
THEODHORI SOLLAKU**